



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit e mbajtur me datë **03.04.2018** me fillim në ora **10.15**, këtë mbledhje e kryesoi anëtari më i vjetër i komitetit për komunitete **z. Ramë Berisha**. **Kryesuesi** – Përshëndetje për përfaqësuesit e OSBE-së, UNMIK- ut, anëtarët e Komitetit për Komunitet dhe të gjithë të pranishmit. Konstatohet se kemi kuorum për mbajtjen e mbledhjes,

REND DITE

1. Zgjedhja e Kryesuesit dhe Zëvendës kryesuesit të Komitetit për Komunitete.
2. Të Ndryshme.

Kryesuesi i Mbledhjes – E qes në aprovim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës.

1. Zgjedhja e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Komitetit për Komunitete.

Si fillim do ju njoftoj me procedurat se si bëhet zgjedhja e e Kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të Komitetit për komunitete. Anëtarët Komitetit zgjedhin Kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin nga mesi i përfaqësuesve të Komuniteteve të cilat nuk janë shumicë në Komunë. Kryesuesi dhe zëvendës kryesuesi i Komitetit për Komunitete zgjedhën nga ky komitet me mandat të njëjtë sikurse anëtarët e këtij Komiteti. Votimi për Kryesuesin dhe Zëvendës kryesuesin e Komitetit bëhet me votë të fshehtë, Kandidati për tu zgjedhur duhet të marrë shumicë të thjeshtë të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Komitetit. Në raste se në votimin e parë asnjëri nga kandidatët nuk e siguron shumicën e kërkuar atëherë dy kandidatët me numrin më të madhe të votave shkojnë në votimin e dytë, kandidati që merë më së shumti vota, do të zgjidhet Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, çdo anëtarë ka të drejtë vote. Ju kisha lutë që secili Komitet të propozoj nga një emër.

Trajko Shariq – Komiteti serb propozon për Kryesues të Komitetit për Komunitete **z. Dushan Stojanović**.

Ramë Berisha - Ne si Komitet RAI e propozojmë për Kryesues të Komitetit për Komunitete **z. Bajram Morina**.

Skender Hamza – Zyra e Kuvendit – Të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete neve na duhet 5 minuta pauzë për ti shtypur emrat në fletëvotime. Së pari ju kisha lutë që secili Komitet të propozoj nga një emër për formim të Komisionit për verifikimin e mbarëvajtjes së votimit dhe numërimin e votave për zgjedhjen e Kryesuesit për Komitetin për Komunitete.

Mirjeta Krasniqi – Ne si Komunitet shumicë propozojmë **z. Ali Zhuniqi**.

Trajko Shariq - Ne si Komunitet serb propozojmë **znj. Aleksandra Veçeviq**.

Bajram Morina – Ne si Komitet RAI propozojmë **z. Ramë Berishën**.

Skender Hamza - I lusë anëtarët e Komisionit që të dalin dhe të shikojnë se a është gjithçka në rregull për të ja filluar me votimin. Pasi është gjithçka në rregull do i ftojme tani të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete një nga një me radhë që të dalin të votojnë: Florida Bajraktari, Bjondina Kleqka, Mirjeta Krasniqi, Ali Zhuniqi, Aleksandra Veçeviq, Darko Antiç nuk gjendet sot për shkak të disa punëve personale, Dushan Stojanović, Ramë Berisha, Bajram Morina. Lusim Komisionin që të bëjë verifikimin dhe numërimin e votave.

Ali Zhuniqi – Kryetar i Komisionit, Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, Pas verifikimit dhe numërimit të votave, gjithsej nga 9 anëtarë sa i ka ky Komitet 8 kanë qenë prezent dhe 8 anëtarë kanë marrë pjesë në votim. Nga ta **z. Bajram Morina** ka marrë 5 vota, kurse **z. Dushan Stojanović** ka marrë 3 vota. Zgjedhja e Kryesuesit bëhet me shumicë të thjeshtë të votave prandaj konstatohet se Kryesuesi i Komitetit për Komunitete është zgjedhur **z. Bajram Morina**, ftoj **z. Bajram Morinën** që të zë vendin e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete.

Bajram Morina - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po ju tregoj një CV të shkurtër timin, Quhem Bajram Morina nga fshati Ratkoc, i takoj Komunitetit pakicë RAI, me profesion jam juristë e kam të përfunduar

fakultetin juridik, ju kisha falënderuar për v=besimin që ma keni dhënë, do mundohem që të japë maksimumin si qytetar i Republikës së Kosovës, do të punojmë së bashku që ky Komitet të ecë me punë sa më mirë.

Skender Hamza – Tani duhet që të vazhdojmë me zgjedhjen e zëvendës kryesuesit të Komitetit për Komunitete, procedura e përzgjedhjes është e njëjtë si zgjedhja e Kryesuesit. Lusim komunitetet që të propozojnë nga një emër:

Aleksandra Veçeviq – Ne si Komunitet serb për zëvendës kryesues propozojmë **z. Dushan Stojanoviq**.

Bajram Morina - Ne si Komunitet RAI për zavendë skryesues propozojmë **z. Ramë Berisha**.

Skender Hamza - Ju faleminderit, 5 minuta pauzë për arsye deri sa të i shtypim në fletëvotime këta dy emra.

Kryesuesi Morina - I lusë anëtarët e Komisionit të dalin dhe të shikojnë se a është gjithçka në rregull për të ja filluar me votimin. Pasi gjithçka është në rregull do fillojmë që ti thërrasim anëtarët e Komitetit për Komunitete një nga një për të dalë për të votuar: Florida Bajraktari, Bjondina Kleqka, Mirjeta Krasniqi, Ali Zhuniqi, Aleksandra Veçeviq, Darko Antiç nuk gjendet sot për shkak të disa punëve personale, Dushan Stojanoviq, Ramë Berisha, Bajram Morina. Lusim Komisionin që të bëjë verifikimin dhe numërimin e votave.

Ali Zhuniqi – Kryetar i komisionit, Pas verifikimit dhe numërimit të votave, gjithsej nga 9 anëtarë sa i ka ky Komitet 8 kanë qen prezent dhe 8 anëtarë kanë mare pjesë në votim. Nga ta z. Ramë Berisha ka mare 2 vota, kurse z. Dushan Stojanoviq ka mare 6 vota. Zgjedhja e zëvendës kryesuesit bëhet po ashtu me shumicë të thjeshtë të votave prandaj konstatoj se zëvendës kryesues i Komitetit për Komunitete është zgjedhur z. Dushan Stojanoviq. Ftoj z. Dushan Stojanoviq që ta zë venin e tij.

Dushan Stojanoviq – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Quhem Dushan Stojanoviq jam nga Komuniteti serb dhe jetoj në Rahovec, ju falënderoj të gjithëve për besimin që ma keni dhënë besoj se do të kemi një bashkëpunim të mirë në të ardhmen dhe shpresoj se do të bëjmë një punë të mirë dhe të mbarë.

Kryesuesi Morina - Me kaq e përfundoj takimin e sodit, ju faleminderit për pjesëmarrje shihemi në takimet e radhës.

Mbledhje ka përfunduar në ora 11:00

Procesmbajtësi,

Skender Hamza

Kryesuesi i Mbledhjes

Ramë Berisha